

KONTRATË

Numri i kontratës ¹: 622-24-2662-1-2-1/C1418

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

OFFICE 1 KOSOVA SH.P.K., Rr. Tirana, PRIZREN, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim me inventar shkollor për shkollat e Komunes se Prizrenit me numër identifikues: 622-24-2662-1-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim** nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Furnizim me inventar shkollor për shkollat e Komunes se Prizrenit

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **3** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë **Shkollat e Komunës së Prizrenit**.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **89,585.00 € (tetëdhjetë e nënt mijë e pesqind e tetëdhjetë e pes euro)**.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

(e) Oferta financiare;

(f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet


6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Isa Osmankaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	14.06.2024
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	Hasan Gigollaj
Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:	
Data:	14.06.2024
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 622-24-2662-1-2-1/C1418

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Plani dinamik i realizimit		Furnizimet do të përfundojnë brenda 90 ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të kontratës
Mbikqyrja dhe inspektimi		Mbikqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës do të jetë Luljeta Veselaj Gutaj Drejtoreshë në DASH Menagjer i projektit: Jahja Baca Ecc në DASH
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria ekzekutimit	9.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është i 10 % vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 6 muaj
Sigurimi	10.1	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Programi ekzekutimit	11	N/A
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	DDP (Delivery Duty Paid)
Patentat dhe licencat	13.1	N/A
Cilësia e furnizimeve	18.2	Autoriteti Kontraktues do të refuzojë çdo dergese të materialit i cili deshton në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësive të përcaktuara në specifikimin teknik.
Inspektimi dhe testimi	19.2	Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe në përputhje me Nenin 19 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuara në Nenin 2.2 të Kontratës.
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për furnizimet e dorëzuara vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues.
Dorëzimi	21.3	Furnizuesi do të'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre.
		Dërgesa:

		Dërgesat do të bëhet brenda _____ ditëve pas marrjes së "urdhër blerjes" nga ana e Furnizuesit. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet e garancionit	24.1	[shëno periudhën e garancionit]
	24.5	N/A
Shërbimet pas shitjes	25.1	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Neni 42 42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë: a) ose vendim nga gjyqi; b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK. 43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Alban Susuri

From: Alban Susuri
Sent: Tuesday, June 11, 2024 9:25 AM
To: 'info@mobelland.net'; 'info@tenaseri.com'; 'granitiholding@gmail.com'
Cc: Isa Osmankaj
Subject: Terheqja e mostrave

Pershendetje

Te nderuar Operator lidhur me tenderin ; Furnizim me inventar shkollor për shkollat e Komunes se Prizrenit , si proceduar eshte perfunduar, andaj ju lutemi qe te vini ne zyren e Prokurimit pran KK Prizren qe te bahet terheqja e mostrave deri me dt 19.06.2024 ora 16:00 , pas kesaj date ne si Auritet kontraktues nuk mundemi te mbajm pergjegjesi per mostrat e dorezuara nga ana juaj

Gjithe te mirat .

AA.G.24
2

AUTORITETI KONTRAKTUES

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, Remzi Ademaj, -20000, PRIZREN,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 622-24-2662-1-2-1

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **OFFICE 1 KOSOVA SH.P.K., Rr. Tirana, 20000, PRIZREN, Kosovë**

E-mail: **office@alteramall.com**

Personi kontaktues: **Hasan Gigollaj**

Telefoni: **049/573573**

Faxi:

Numri fiskal: **810611998**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 622-24-2662-1-2-1

Titulli i kontratës: Furnizim me inventar shkollor për shkollat e Komunes se Prizrenit

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Furnizim me inventar shkollor për shkollat e Komunes se Prizrenit

3. Çmimi total i tenderit është:

89,585.00 EUR

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.


5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj

Furnizimi me inventar shkollor

	përshkrimi i elementeve	sasia	çmimi njësi, me tvsh	totali
1	Banke shkollore nga konstruksioni çelk preciz i klasit te larte,tuba ovale me dim:38/20/1.5mm),tablla mbeshtet ne tuba drejtkendor me dim" (38/20/1.5mm) Ngjyra RAL:3000 .Ne tubat e çelikut duhet te aplikohet shtresa permes procesit elektrostatik me pluhur rreshire epokside ne temperature 220 °per te siguruar nje siperfaqe qe eshte rezistente ne gervishtje,dy sirtar per per libra .Materiali i tabllës duhet te jete md f me shtresen e posaqshme per shkolla me trashësi 18-22mm i posaqshem me dim:130x50 dhe i mveshur si dhe panellin mbrojtës te qantave sipas skices .Ngjyra RAL:3000 .Ne tubat e çelikut duhet te aplikohet shtresaMbrojtëse te plastikes per te parandaluar demtimin e dyshemës. Shih foton ,skicën -vizatimin. Me mostra ne ditën e hapjes se ofertave 	540 cope	€ 60.00	€ 32,400.00
2	Karrike metal-dru nga konstruksioni çelkpreciz klasit te larte ,tuba oval me dim:38/20/1.5mm)ulesja mbeshtet ne tuba drejtkendor me dim (38/20/1.5mm)Ngjyra :RAL 3000 .Ne tubat prej çeliku duhet te aplikohet shtresa permes procesit elektrostatik me pluhur rreshire epokside ne temperature 200°per te siguruar nje siperfaqe qe eshte rezistente ne gervishtje,Mbrojtëse te plastikes per te parandaluar demtimin e dyshemës.Ulesja dhe mbeshtetja e shpines e lakuar nga materiali dru ,dhu i lameluar 8mm Ngjyra llak transparent .Dru i lameluar 8mm. Shih foton ,skicën-vizatimin. Me mostra ne ditën e hapjes se ofertave 	1080 cope	€ 31.50	€ 34,020.00
3	Tavolinë pune (130x80cm), drejtkëndëshe me orman me 4 fioka, me rrota, per arsimtarin ne klase. Tavolina duhet te jete nga materiali mediapan. Dizajni dhe kualiteti i tavolines duhet te jete i larte.	36 cope	€ 150.00	€ 5,400.00
4	Tavolinë drejtkëndëshe (për takime), për 15 persona me dim.270x200x75cm, d=3cm. Dizajni dhe kualiteti i tavolines duhet te jete i larte.	4 cope	€ 200.00	€ 800.00
5	Orman per ditarë me dim. standarde per 20 ditarë	6 cope	€ 150.00	€ 900.00



6	Vitrina me Xhama 200x80x40cm	30 cope	€ 150.00	€ 4,500.00
7	Vitrina pa Xhama 200x80x40cm	30 cope	€ 150.00	€ 4,500.00
8	Karriga statike - karriga me konstruksion metalik, me profile metalike standarde, ulese dhe mbeshtetese nga sfungjeri i mbeshtjellur me stof cilesor ku ngjyren e percakton investitori.	50 cope	€ 25.00	€ 1,250.00
9	Furnizimi dhe montimi i elementeve per zyre administrate, komplet me pajisje te nevojshme si tavoline pune ekskluzive, karriga ekskluzive, orman per dokumente. Masa sipas vendit 	2 set-e	€ 1,000.00	€ 2,000.00
10	Tabelë shkrimi (shkolllore e gjelbërt) me dimensione 120cm x 240cm, sipërfaqe speciale laminat 0.50mm. Nën sipërfaqen e tabelës është material dërrase e grirë 8 mm, e cilësisë E1. Në anën e pasme përdoret letra embos ose laminat primer. Kornizat anësore janë kornizë metalike prej alumini 20x18mm. Ka një mbajtëse lapsash dhe shpuze në fund. Si dhe për montim në mur përdoren kënde plastike në të katër cepat, dhe mbi to ka vende të fshehura me vida. Me mostra ne ditën e hapjes se ofertave. 	70 cope	€ 54.50	€ 3,815.00
gjithsej			89,585.00 €	

Vërejtje: Të sillen mostrat e pozicioneve: 1,2,10 para hapjes së tenderit. Transportimi i inventarit do të bëhet deri në shkollën e caktuar nga DKA. Furnitori është i obliguar që tabelat e shkrimit ti montoj nëpër vendet e caktuara nga ana e drejtorisë së shkollës.





0055526

NUMRI I POLICËS	055526
SIGURUESI	K.S. SCARDIAN J.S.C Adresa: Rr. Perandori Justinian 3, 10000 Pristine, Kosovo
AGJENTI	Bersant Beqiri Adresa: Rr. Rifat Ukmeri nr. 50
I SIGURUARI	OFFICE 1 KOSOVA SH.P.K Adresa: Tirana P.N
NUMRI I BIZNESIT	810611998
NUMRI FISKAL	810611998
QËLLIMI I SIGURIMIT	Garanci e Kontratës
PËRFITUESI	KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
TITULLI I KONTRATËS	FURNIZIM ME INVENTAR SHKOLLOR PER SHKOLLAT E KOMUNES SE PRIZRENIT
NUMRI I IDENTIFIKIMIT-PROKURIMIT	622-24-2662-1-2-1
TERRITORI I MBULIMIT	Republika e Kosovës
PERIUDHA E SIGURIMIT	183 ditë
SHUMA E SIGURUAR	8,958.50 EURO
Nga:	14-06-2024
Deri:	14-12-2024
PRIMI I SIGURIMIT	161.25
TVSH 18 %	29.03
PRIMI +TVSH 18%	190.28
DATA E LËSHIMIT	2024-06-14 09:27:39

VËREJTJE:

Polica e sigurimit të Garancive është krijuar në bazë të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 10.05.2012, gjithashtu sipas Rregullave dhe Rregulloreve të Aprovuara nga Banka Qendore e Republikës së Kosovës. Pjesë përbërëse e kësaj police janë Kushtet e përgjithshme, pyetësori i plotësuar dhe të nënshkruar dhe çfarëdo dokumenti tjetër i bashkangjitur me me policën e sigurimit.

Kjo police sigurimi vërteton lidhjen e kontratës, dhe lëshohet nga Siguruesi në bazë të deklarimeve dhe kërkesave të bëra nga i Siguruarit/përfaqësuesi i të siguruarit, i cili është përgjegjës lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të bëra prej tij.

Unë i Siguruarit/ përfaqësuesi i të siguruarit, deklaroj se i kam lexuar me vëmendje dhe i kam kuptuar kushtet e kontratës së sigurimit, deklaroj se pajtohem me to, si dhe me të dhënat dhe përcaktimet e kësaj police sigurimi, dhe po nënshkruaj konform vullnetit tim të lirë, e të plotë.

I SIGURUARI

Hasan Gogolaj
(emri, mbiemri, nënshkrimi)



SCARDIAN

[Signature]
(emri, mbiemri, nënshkrimi)